



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i modulit: PËRKTHIM TEKNIK NË FUSHËN E MJEKËSISË

(KSHK 7, Kualifikim për të nxënësit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip

Ngarkesa: 3 ECTS

Kohëzgjatja : 30 orë;

Lloji i trajnimit: Drejtëpërdrejtë, online

Forma e zhvillimit: Nëpërmjet metodave interaktive, aktiviteteve mësimore dhe seancave praktike

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Qëllimi kryesor i lëndës *Përkthimi i terminologjisë mjekësore* në gjuhën të huaj është të mundësojë njohjen e terminologjisë së specializuar të përdorur në mjekësi, për të komunikuar me personelin mjekësor dhe atë infermieror, për të kuptuar diagnozat dhe trajtimet e tyre dhe për të lexuar dhe kuptuar dokumentacionin mjekësor në gjuhën të huaj. Në përgjithësi, objektivat e kësaj lënde janë të ndihmojnë në sigurinë dhe kujdesin e shëndetit të pacientëve në nivel global duke siguruar që i gjithë dokumentacioni mjekësor dhe komunikimi midis mjekëve dhe infermierëve dhe pacientëve të jenë të saktë dhe të kuptueshëm në gjuhë të ndryshme.

Objektivat:

- Përkthimi i dokumentacionit mjekësor, siç janë kartelat e pacientëve, analizat e laboratorit, raportet e spitalit dhe recetat mjekësore
- Përkthimi i materialeve informuese për pacientët, siç janë broshurat dhe fletëpalosjet për sëmundje të ndryshme, trajtimet dhe vaksinat e ndryshme
- Përkthimi i artikujve shkencorë dhe kërkimeve mjekësore në fusha të ndryshme të mjekësisë
- Përkthimi i dokumenteve të tjera të lidhura me fushën e mjekësisë, siç janë kontratat dhe marrëveshjet me kompanitë farmaceutike dhe të sigurimeve shëndetësore
- Sigurimi i një niveli të lartë profesionalizmi dhe saktësie në përkthimet e dokumenteve mjekësore, duke respektuar etikën dhe rregullat e fushës së mjekësisë

KONCEPTET THEMELORE:

1. **Terminologjia:** Përkthyesit duhet të kenë njohuri thelbësore të terminologjisë mjekësore në gjuhën e tyre të punës dhe në gjuhën e burimit të tekstit që po përkthehet. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë dhe të përkthejnë saktë terminologjinë mjekësore në mënyrë që të sigurojnë që përkthimi të jetë i saktë dhe i kuptueshëm

2. **Konteksti mjekësor:** Përkthyesit duhet të kenë njohuri të mirë të kontekstit mjekësor dhe të jenë në gjendje të kuptojnë rrethanat mjekësore të pacientëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

3. **Saktësia:** Saktësia është një koncept thelbësor në përkthimin mjekësor. Përkthyesit duhet të jenë të saktë në përkthimin e terminologjisë mjekësore.
4. **Kultura dhe normat mjekësore:** Përkthyesit duhet të jenë të njohur me kulturën dhe normat mjekësore të vendeve të të ndryshme. Kjo ndihmon në përkthimin e teksteve në një mënyrë që të respektojnë kulturën dhe normat mjekësore të të dy vendeve;
5. **Etika:** Përkthyesit duhet të kenë një kuptim të qartë të etikës dhe kodit të sjelljes në mjedisin mjekësor. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për privatësinë dhe konfidencialitetin e pacientëve dhe të jenë në gjendje të ruajnë këto vlera në përkthimin e teksteve mjekësore.